



# Bilbilenjtë trembëdhjetë



CITTA' di CHIERI  
CONSIGLIERE COMUNALE  
*Vincenzo Cucci*

ODHISE K. GRILLO

# *Bilbilenjtë trembëdhjetë, vanë në litarë vetë!*

Ilustrimet:  
Vehap Kokalari



BOTIMET TOENA

Tiranë 2000



BIBLIOTECA



Bilbil Shakoja ishte bilbil nga goja, po edhe dorën e kishte shpatë, e kur bintë mbi pushtuesit osmanë dridhej toka nën këmbët e tyre e dridheshin edhe armiqjtë. Pa na kishte Bilbili një tufë me trima në fshatin e tij, që mbanin emrin Bilbilenj. Edhe ata ishin të gojës e të shpatës, si i pari i tyre, e të merrnin gjak në vetull.

Një ditë i mblodhi Bilbili të dymbëdhjetë, e ai vetë trembëdhjetë, dhe u tha:

- A e dini pse kam marrë malet me pushkë në krahë, me gjerdan e me shpatë në brez? Se dua t'u pres kokat osmanëve, që na dogjën e na ropën, na vranë e na shkretuan tërë tokën. Pastaj na mbytin me xhelepe e na degdisin në Jemen e Mesollonjë si nizamë... Mirëpo atdheu që është yni na thërret e na thotë: "Ku jeni, o djem? Pse nuk ngriheni t'u bini pa mëshirë, t'i flakni zinxhirët e ta çlirojmë mëmëdhenë?..."

- Do të vijmë edhe ne pas teje, xha Bilbil - thirrën të dymbëdhjetë djemtë e nipat e tij dhe brofën në këmbë e kapën armët në duar.



Dhe u nisën pas Bilbilit duke kënduar e duke ngjitur malin me këngë në gojë. Kënga thoshte se kishin marrë malin, pasi kishte dalë shkurti e po hynte marsi, kur çelin lulet e gjelbëron bari... Pa kënga thoshte se po delnin komitë malit të Këndrevicës dhe për jastëk do të kishin armët, për jorgan qiellin e kaltër e për dyshek tokën e dashur. Dhe po të mos kishin bukë do të hanin lakra e rrënë. E po të mos kishin edhe lakra e rrënë do të jenonin dukë kënduar këngë...

Kur morën vesh në Janinë se Bilbil Shakoja me dymbëdhjetë bilbilenj të tjerë po bënин kërdinë mbi forcat e sulltanit, osmanët nisën të dridhen siç dridhen valet në liqenin e Janinës. Pa qanin nuset e gratë e osmanëve se ata që shkonin në Rexhinë nuk ktheheshin më në Janinë, as të gjallë e as të vdekur...



Prandaj pashai i Janinës mblodhi agallarë, bejlerë, hoxhallarë e dervishlerë dhe u tha:

- Dua që të më zini të gjallë të trembëdhjetë bilbilenjtë dhe të m'i bini këtu të gjallë. Po të mos i kapni dot me pusira, paguani lira e ngrini kurthe. Ai që t'i zërë do të gdhijet i pasur e me grada në supe.

Bejlerët e agallarët dhe gjithë të tjerët u gudulisën e u lëpinë nga fjalët e fundit të pashait, po asnjë nuk donte të shkonte në Rexhinë, se atje i priste pushka e shpata e bilbilenje. Se në Rexhinë bilbilenjtë ndiznin edhe strallin e të hapnin varrin...

Do të vijnë edhe ne pas teje, xha Bilbil - thirrën të dymbëdhjetë djemtë e ntpat e tij dhe brofën në këmbë e kapën armët në duar.



Si rrufi mbi osmanet. Pa viste me pusnik e gjonte me

Sa mbaroi fjalën pashai, Xhelil Voshtina, një bez nga Voshtina, e thuri përnjëherësh planin si do t'i kapte të trembëdhjetë bilbilenjtë, prandaj u ngjesh me alltie e me martinë dhe hapi fjalë anembanë se pashai e kishte ngrënë në besë, se pashai nuk e mbante fjalën dhe donte ta hante nga pas ashtu siç të ha qeni... Prandaj do të shkonte të bashkohej me bilbilenjtë e të luftonte krahpërkrat me ta kundër pashait të Janinës.

"Mos i besoni beut se jua kâ me të pabesë dhe do t'u shesë e do t'u hajë në besë!"



qif e vishnun i dëgjan. Tof te eme i kapni döt me  
pusira, paguari lira e nigrini kurthe. Ai që t'i zërë do të

5 Bilbilenjtë e besuan se nuk i dëgjuan fushat e malet  
kur thanë duke qarë:

“Mos e besoni beun se jua ka me të pabesë dhe do t'u  
shesë e do t'u presë në besë!”



Çeta e bilbilenjve zinte prita e ngrinte pusira dhe binte si rrufe mbi osmanët. Pa vriste me pushkë e grinte me shpatë. Në humnerat e honet e Rexhinit u hapej fustanella si krahë shqiponje... Pa u ndriste jatagani, u hapej xhamadani, dhe gjoksi i tyre kthehej në shesh mejdani. Se ata kishin nga shtatë zemra e jo nga një.

Bashkë me ta bënte sikur luftonte edhe Xhelil Voshtina, e sillej sikur të ishte bilbili i katërmëdhjetë.

Dhe një ditë të zezë sterrë na i ftoi të trembëdhjetë bilbilenjtë në sarajet e veta. Ata prapë i besuan edhe pse malet e fushat qanë dhe u thanë:

“Mos i besoni beat se jua ka me të pabesë dhe do t'u shesë e do t'u hajë në besë!”



Në saraje u therën katërmëdhjetë qengja, që u poqën  
në hell, dhe rakia e vera u derdhën lumë. Xhelil Voshtina  
bënte sikur pinte e hante.

"Mos i pësoni pemt se lus ka me të bëpëse qire do t'u  
shfësë e qo t' n'johë tig jetë".

"Voshtina" e s'likë sikur t' i përfi pëllumbat e këtij vjeti.

"Dhe ulje qire t' është sërisht e veta. Aja bësë i përsnu edhe

"Pipilëtë e tuzitë e tuzitë e tuzitë".

"Bësë mëstët e tuzitë e tuzitë e tuzitë".

"Mës i pësoni pemt se lus ka me të bëpëse qire do t'u

"shfësë e qo t' n'johë tig jetë".



Në tē vërtetë ai priste mesantën, kur tē bërë çakërrqejf,  
tē trembëdhjetë bilbilenjtë do tē shtriheshin nēpér jatakë  
pér tē fjetur.

Mos u nxito, o Xhelil Voshtina, mérre mō isto qaré  
mē ngadalé, se do tē vijë dita që tē piqemi nēpér male.



Dhe ajo orë erdhi. Xhelili doli në oborr, ndezi një pishtar për të lajmëruar forcat që i printe vetë pashai dhe u hapi dyert. Osmanët hynë si hajdutë nëpër odat ku flinin trimat dhe i kapën në gjumë e i lidhën me zinxhirë. Kështu bilbilenjtë nuk i përdorën dot as pushkët e as shpatat.



Xhelil Voshtina doli në krye të tyre dhe, duke fërkuar  
mjekrën, thirri me të madhe:

- Kaq e patët, o bilbilenj!

Bilbilenjtë nuk folën me fjalë po me pështymat që i  
hodhën në surrat. Dhe i pari i tyre, Bilbili, tha:

- Mos u nxito, o Xhelil Voshtina, merre më shtruar e  
më ngadalë, se do të vijë dita që të piqemi nëpër male.



Do të piqemi patjetër dhe ti nuk do të shpëtosh prej nesh. Këtu do ta lesh kokën. Edhe po nuk u poqe me ne, do të piqesh me të tjerë. Se ky vend, pranverë për pranverë do të nxjerrë të tjerë trima si ne. Rexhini do të nxjerrë patjetër bilbilenj të rinj...

Mëngjes herët nga Voshtina doli një karvan me osmanë. Në mes të tyre çapiteshin me ballin lat e me sytë shpuzë trembëdhjetë bilbilenjtë të lidhur këmbë e duar me zinxhirë. Kur i shikonin malet qanin me lot të nxehjtë, se u dhimbeshin të trembëdhjetë trimat. E pas tyre qanin edhe fushat, pyjet e koriet nga kishin shkelur këmbët e tyre e nga ish dëgjuar pushka e tyre. Në ballë u printe Bilbili me nofullat të shtrënguara si darë. Nga pas i shkonin djemtë e nipërit duke ngrënë veten me dhëmbë, që i zunë të gjallë e nuk shtinë dot asnjë pushkë e nuk nxorrën dot shpatat nga milli...

Ecnin e ecnin papushuar, duke kënduar këngë trimash shqiptarë, që flisnin për Skënderbeun e për Gjergj Golemin, po edhe për shqiponjën e për skifterin, se shqiponja e skifterë kishin qenë bilbilenjtë.



Bilbili Shkukja, boshqet me qytetin e pashanë  
dhe tha: « Të dyshëm rëqëm, vjaja e sëmundjeve  
dhallë, po

- Ngadalë, ngadalë, ngadalë! Po  
bilbilenjtë gjuhën e sa duam të shikosh si Xhelil Voshtina e mos  
edhe ca fjalë që t'u dëjtin jashtë. Po ne shqipëritët i fshihur në  
tumanet e grave. Dhe më dëshmi i shkupi me qytetin e qataganit të  
shqiptarëve. Pse zbythesh e fshihesh pas taborrit? Eh, more këlysh i Anadollit.

Me gërshtë, pas tyre shkonte Xhelil Voshtina i rrrethuar nga dhjetra

osmanë. Ai ëndërronte... duke e parë veten me grada e

nishane dhe me qese plot florinj...

- Ngadalë, ngadalë, ngadalë! Po  
bilbillerjë me pallë, se duam te dredhim nga një cigare. Pa afrohi, o Xhelil  
Voshtina, o bir bushtrë, e mos u fshih në tumanet e grave. Dil të shikosh si  
vdesin trimat... Dhe mbaje mend: nuk ke për t'i shpëtuar jataganit të  
shqiptarëve... Pse zbythesh e fshihesh pas taborrit? Eh, more këlysh i Anadollit.  
Me gërshtë do të ta presin mishin trimat tanë kur të të kapin.

- Hidhuni litarin! - ulëriti pashai,

- Hidhuni litarin! - ulëriti edhe Xhelil Voshtina.



Ec e ec më në fund u duk një rrap degëtendë, në një shesh të madh, në mes të Janinës. Aty, nëpër degët e rrapit ishin varur trembëdhjetë litarë. Sa u afroan osmanët e bilbilenjtë, zogjtë e ndërprenë këngën dhe fluturuan larg, për të dhënë lajmin e zi... Bilbili me djemtë u shpërndanë si zogj dhe secili shkoi te litari i vet. Xhelil Voshtina thirri:

Mëngjes he - Ua hidhni litarët në qafë!

Bilbili me osmanë. Në mes të tyre capiteshin me këmbë e dual me zinxhi. Kui i Shkodrës matë Janin me lojtë zinxhi, se u dhimbeshin të trembëdhjetë trimet. E pas tyre Janin e dëgjuat, pyjet e koriq nga kishin shkelur këmbët e tyre e nga ish dëgjuar pushka e tyre. Në ballë u printe Bilbili me nofullat të shtrënguara si darë. Nga pas i shkonin djemtë e niperit duke ngrënë veten me dhëmbë, që i zunë të gjallë e nuk shtinë dot asnjë pushkë e mik nixorrën dot shpatat nga milli...

Eenin e ecnin papushuar, duke kënduar këngë trimash shqiptarë, që fletin për Skënderbeun e për Gjergj Golemin, po edhe për shqiponjën e për skifterin, se shqiponja e skifterë kishin qenë bilbilenjtë.



Bilbili Shakoja i gozhdoi me sytë e tij të zjarrtë Xhelil Voshtinën e pashanë dhe tha:

- Ngadalë, o bej, ngadalë, o pasha, se nuk jemi canakë me dhallë, po bilbilenjtë me pallë, se duam të dredhim nga një cigare. Pastaj duam të themi edhe ca fjalë që t'u djegin për gjithë jetën... Pa afrohu, o Xhelil Voshtina e mos rri fshehur vrimave. Dil të shikosh si vdesin trimat. Mos rri i fshehur në tumanet e grave. Dhe mbaje mend: nuk ke për t'i shpëtuar jataganit të shqiptarëve... Pse zbythesh e fshihesh pas taborrit? Eh, more këlysh i Anadollit. Me gërshërë do të ta presin mishin djemtë e Rexhinit dhe të Progonatit!

Pas tij nisën të flasin edhe dy mbëdhjetë bilbilenjtë e tjerë:

- Ngadalë, o bej, ngadalë, o pasha, se nuk jemi çanakë me dhallë, por bilbilenjtë me pallë, se duam të dredhim nga një cigare. Pa afrohu, o Xhelil Voshtina, o bir bushtre, e mos u fshih në tumanet e grave. Dil të shikosh si vdesin trimat... Dhe mbaje mend: nuk ke për t'i shpëtuar jataganit të shqiptarëve... Pse zbythesh e fshihesh pas taborrit? Eh, more këlysh i Anadollit. Me gërshërë do të ta presin mishin trimat tanë kur të të kapin.

- Hidhuni litarin! - ulëriti pashai.
- Hidhuni litarin! - ulëriti edhe Xhelil Voshtina.



- Mos pranoni t'u varin, o bijtë e nipërit e mi! - thirri kapedan Bilbili. - Çohuni dhe hidheni litarin vetë, si shqiptarë që jeni.

Dhe të trembëdhjetë bilbilenjtë e hodhën litarin në qafë dhe ia nisën këngës:

*Hidheni litarin vetë,  
sa të tundet rrapi i shkretë,  
të këndojnë degë e fletë,  
si për mua dhe për djemtë:  
Bilbilenjtë trembëdhjetë,  
vanë në litarë vetë!*

**LEGJENDA SHQIPTARE - 14**

**libra të ilustruar për fëmijë**

## **BILBILENJTË TREMBËDHJETË**

**Autor: Odhise Grillo**

**Piktor: Vehap Kokalari**

**Përkujdesja grafike: Irena Toçi**

**Janë në qarkullim nga e njëjta kolanë:**

**SKËNDERBEU**

**BESA E SHQIPTARIT**

**DY BATOT DHE ZANA E ILIRISË**

**MARO KONDA, TRIMËRESHË!**

**TRIM MBI TRIMA, GJERGJ ELEZ ALIA!**

**PRITE, PRITE AZEM GALICËN!**

**KAPEDAN ÇELO PICARI**

**KËSHTJELLA E ROZAFATIT**

**PO KU JE ADEM JASHARI?!**

**KOSTANDINI DHE DHOQINA**

**OSO KUKA NË KULLË T'BAROTIT**

**ZANAT E MALIT DHE FUQIA E MUJIT**

**LEGJENDA E NJË SHKËMBI**

**BILBILENJTË TREMBËDHJETË**

**ZEMRA E NËNËS**

**NORA E KELMENDIT**

**LULE, O ZENEL GJOLEKA!**

**PIRROJA I EPIRIT**

**DAMJAN HIMARJOT VETËTIMA**

**MIC SOKOLI ME SHTATË ZEMRA**